

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

"ÇABRATI" SH.A.-JSC-DD.
GJAKOVË

Nr.No.Br. 755 Shtese 1

Dt. 12. 04. 2024

KRM ÇABRATI SH.A.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

Përmbajtja**Faqe**

Raporti i auditorit të pavarur dhe Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative	2 – 5
Pasqyra e Pozicionit Financiar	6
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e Ndryshimeve në kapital	8
Pasqyra e Rjedhës së Parasë	9
Shënimet në pasqyrat financiare	10 - 23

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e K.R.M. Çabrat SH.A.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.M. Çabrat SH.A. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2023 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve tek baza për opinion me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion me rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 6 të Pasqyrave Financiare, llogaritë e arkëtueshme tregtare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 janë 1,087,001 Euro dhe me 31 dhjetor 2021 në vlerë 1,071,295 Euro neto nga provizionet e borxheve të këqija dhe dyshimta 234,477 Euro për 2021 dhe 2020. Gjatë vitit 2023 Kompania kishte inkasuar 41,636 Euro nga borxhet e këqija. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse Kompania do jetë në gjendje të inkasojë vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezantuara. Kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë më 31 dhjetor 2023. Për më tepër, Kompania nuk ka aplikuar në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në lidhje me provizionimet e llogarive të arkëtueshme. Në mungesë të analizave historike të kërkuara nga SNRF 9 dhe përcaktimin e modelit të kalkulimit të provizioneve në llogaritë e arkëtueshme ne nuk mund të vlerësojmë se sa do mund të jetë efekti në provizionim nëse do të përfillin në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në kalkulimin e provizionit.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int L.L.
20 mars 2024



RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të K.R.M. Çabрати SH.A. si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor te kompanisë K.R.M. Çabрати SH.A. për periudhën 01 janar 2023 deri me 31 dhjetor 2023, me datë 06 shkurt 2023 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

Vlerësimet kontabël

Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

Përgjigja e auditorit

- o Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
- o Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
- o Rishikimi i saldoeve dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. LLC
20 mars 2024



KRM ÇABRATI SH.A.


Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

	<i>Shënime</i>	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Pasuria			
Toka, prona dhe pajisjet	5	4,519,142	2,758,634
Pasuria jo-rrjedhëse		4,519,142	2,758,634
Pasuria rrjedhëse			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	1,000,262	1,127,699
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	142,367	165,438
Gjithsej pasuria rrjedhëse		1,142,629	1,293,137
Gjithsej pasuria		5,661,771	4,051,771
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	1	471,472	471,472
Rezerva e rivlerësimit	5	3,533,142	1,871,154
Fitimi i mbajtur		1,056,685	1,188,807
Gjithsej kapitali		5,061,299	3,531,433
Detyrimet rrjedhëse			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	52,978	45,809
Detyrimet tatimore	9	17,826	20,949
Të hyrat e shtyera	10	529,668	453,580
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		600,472	520,338
Gjithsej kapitali dhe detyrimet		5,661,771	4,051,771

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të Bordit më 20 mars 2024.


Behar Ferizi
Kryeshef Ekzekutiv


Leudita Nela
Zyrtar Kryesor financiar


Valton Tytynxhiu
Kontabilist i Çertifikuar



Shënimet shoqëruese në faqet prej 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar

KRM ÇABRATI SH.A.

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për dhe më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
	<i>Shënimet</i>		
Të hyrat nga shërbimet	11	1,601,646	1,590,578
Gjithsej të hyrat		1,601,646	1,590,578
Të ardhurat tjera	11	126,380	40,483
Shpenzimet e personelit	12	(1,044,437)	(985,847)
Shpenzimet e materialit	13	(265,641)	(288,164)
Shpenzimet tjera	14	(51,687)	(35,578)
Shpenzimet tjera afariste	15	(339,191)	(258,513)
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	(173,151)	(70,000)
Gjithsej shpenzimet		(1,747,727)	(1,597,619)
Fitimi operativ		(146,082)	(7,040)
Të ardhurat tjera të jashtëzakonshme	11	13,960	25,949
Të ardhurat nga donacionet	11		
Fitimi para tatimit		(132,121)	18,909
Shpenzimet e tatimit në fitim	16	-	(2,933)
Fitimi neto i vitit		(132,121)	15,975
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të hyrave gjithëpërfshirëse për vitin		(132,121)	15,975

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRM ÇABRATI SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për dhe më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i mbajtur	Gjithsej
Balanca me 1 janar 2022	471,472	1,871,154	1,172,831	3,199,073
Fitimi i vitit	-	-	15,975	15,975
Të ardhurat/humbjet tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat/humbjet të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	15,975	15,975
Rregullim	-	-	-	-
Dividenta	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	471,472	1,871,154	1,188,807	3,215,048
Balanca me 1 janar 2023	471,472	1,871,154	1,188,807	3,215,048
Fitimi i vitit	-	-	(132,121)	(132,121)
Të ardhurat/humbjet tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat/humbjet të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(132,121)	(132,121)
Shtesa	-	1,661,988	-	1,661,988
Dividenta	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	471,472	3,533,142	1,056,685	4,744,915

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRM ÇABRATI SH.A.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për dhe më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Flukset e parase nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		(132,121)	18,909
<i>Korigjime për:</i>			
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	173,151	70,000
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues		41,030	88,909
Ndryshimet në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	127,437	127,117
Ndryshimet në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	8	7,169	3,898
Ndryshimet në detyrimet tatimore	9	(3,123)	(2,756)
Ndryshimet në të hyrat e shtyera	10	76,087	440,507
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		207,570	568,764.82
Pagesa e tatimit	16	-	(2,933)
Neto paraja e gjeneruara nga aktivitetet operative		248,600	654,740
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e asetëve	5	(271,672)	(606,257)
Shlyerje e asetëve	5		7,500
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(271,672)	(598,757)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Divedenda		-	-
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja neto e parasë dhe të ngjashme		(23,071)	55,983
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fillim të periudhës	7	165,438	109,455
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fund të periudhës	7	142,367	165,438

Shënimet shoqëruese në faqet prej 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

1. Informata mbi kompaninë

Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabrati Sh.A. është themeluar si shoqëri aksionare. Kompania është themeluar me datë 12/28/2007, dhe operon në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëri tregtare" Nr.06/L-016 dhe ligji "Për marka tregtare" Nr.04/L-026, me numër unik identifikues 811299165. Adresa e kompanisë është Gjakovë, M.Lakuci.

Shoqëria ka 1 aksionar: Kuvendi Komunal Gjakovë me 100 % të aksioneve në vlerë 471,472 Euro.

Aktiviteti primar i kompanisë është grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme. Kompania poashtu ofron edhe shërbime tjera si: grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme.

KRM ÇABRATI SH.A. ka pasur 176 punëtorë me 31 dhjetor 2023 (2022: 159 punëtorë).

2. Baza për përgatitjen e pasqyrave financiare

2.1 Baza e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Pasqyrat financiare janë përgatitur në euro, e cila është edhe monedha funksionale e Entitetit.

2.2 Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e koston historike.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Toka, prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pasurive jo qarkulluese paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e pasurisë. Kur pjesë e një elementi të pasurive joqarkulluese kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të pasurive joqarkulluese.

Artikujt e Pronës, impianteve dhe pajisjeve deri më 1 janar 2016 prezentohen në pasqyrat financiare sipas koston së vlerësuar minus çdo zhvlerësimi dhe humbje e akumuluar nga zhvlerësimi, përderisa artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve pas 1 janari 2016 vlerësohen sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë zhvlerësim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim.

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur me 31 dhjetor 2023.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rjedhin për ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të pasurive joqarkulluese njihet me vlerën e bartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i përkasin kompanisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.1 Toka, prona dhe pajisjet (vazhdim)

Humbja nga dëmtimi i aseteve. Në fund të çdo date të raportimit, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një asetit me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi (dëmtimi) e njohur për një aset në vitet paraprake rikthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e asetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Zhvlerësimi. Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese:

	2023	2022
Ndërtesa	5 %	5 %
Mjete dhe pajisje	20 %	20 %
Makina/kamionë	20 %	20 %

Vlera e mbetur e një asetit është vlera e parashikuar që kompania aktualisht do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e asetit minus kostot e vlerësuar të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse asetit ishte tashmë në moshë dhe në gjendje që pritet të jetë në fund të jetës së saj të dobishme. Vlerat e mbetura të aseteve dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe korrigjohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël neto dhe njihen neto brenda të ardhurave/shpenzimeve tjera operative në fitim ose humbje.

3.2 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet janë paraqitur me vlerën e tyre reale të korrigjuar për pjesën e provizionimit mbi borxhet e këqija.

3.3 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë, paraja në llogaritë rrejdhëse bankare në banka komerciale.

3.4 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të pagueshmet tjera maten në kosto e cila është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar pa marrë parasysh se a i janë faturuar organizatës apo jo.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.5 Grantet qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet. Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është i lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzim. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzimet e lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm. Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit.

3.6 Njohja e të hyrave

Të hyrat janë të matura dhe të njohura sipas kërkesave të SNRF-ve, Kompania ka njohur të hyrat kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- Kur shuma e të hyrave mund të matet saktësisht.
- Kur benefite ekonomike të ndërlidhura me transaksionin janë transferuar te entiteti.
- Faza e kompletimit dhe raportimit mund të matet në mënyrë të besueshme dhe saktë.
- Kostot e noddhura për dhënie të shërbimit mund të maten dhe të dihen saktë.

3.7 Tatimi në fitim

Shpenzimi i tatimit në fitim përbëhet nga tatimi aktual i pagueshëm dhe tatimi i shtyrë, nëse ka. Tatimi i paraqitur në pasqyrat financiare është në pajtim me ligjet tatimore aplikative në Kosovë, Ligjin Nr.06/L-105 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave.

Tatimi aktual

Tatimi aktual i pagueshëm ose i mbledhshëm llogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të vitit. Fitimi i tatueshëm ose humbjet e bartura dallojnë nga fitimi, siç raportohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, për shkak se disa të ardhura dhe shpenzime janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera ose asnjëherë nuk tatohen apo zbriten. Detyrimet e kompanisë për tatimet aktuale llogariten në bazë të normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet në bazë të ndryshimeve ndërmjet vlerës së bartur të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatimit të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm. Tatimi i shtyrë detyrim njihet në përgjithësi për të gjithë diferencat e përkohshme të zbritshme vetëm në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit ndryshimet e përkohshme të zbritshme mund të shfrytëzohen.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Përfitimet e punëtoreve

Kompania nuk bën asnjë provizion për dhe nuk ka asnjë obligim për pensionet e punonjësve mbi dhe përtej kontributeve të paguara në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

3.9 Koncepti i vijmësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijmësisë, e cila nënkupton realizimi i aseteve dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit. Kompania ka qëndrueshmëri financiare, nga participimi i anëtarëve të saj ka mbuluar të gjitha kostot e nevojshme për operim.

3.10 Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhjes së mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Një provizion njihet nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundshme që një dalje e mjeteve që trupezojnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimit.

3.14 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë:

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 i nënshtrohen inspektimit nga autoritetet tatimore vendore, ku menaxhmenti i kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë për të qenë në përputhje me ligjet tatimore. Si rezultat, autoritetet tatimore mund kenë vlerësim të ndryshëm nga vlerësimi aktual për detyrimin tatimor.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve

Në rrjedhën normale të biznesit, kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

5. Prona, pajisjet dhe impiantet

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Mjete dhe pajisje	Makinat/ Kamionët	Donacion Kamionat (GIZ)	Total
Balanca më 1 janar 2022	2,110,000	1,905	77,331	605,317		2,794,553
Shtesa	-	29,187		91,270	485,800	606,257
Hegje	-	-		(7,500)		(7,500)
Balanca më 31 dhjetor 2022	2,110,000	31,092	77,331	689,087	485,800	3,393,310
Shtesa	-		57,626	7,880	206,165	271,672
Shtesat nga Rezerva e Rivleresimit	1,271,000	150,000		240,988		1,661,988
Hegje	-					-
Balanca më 31 dhjetor 2023	3,381,000	181,092	134,957	937,955	691,965	5,326,969
Zhvlerësimi i akumuluar						
Balanca më 1 janar 2022	-	(570)	(34,357)	(529,748)	-	(564,675)
Zhvlerësimi për vitin	-	(97)	(4,332)	(25,088)	(40,483)	(70,000)
Hegjet	-	-	-	-		-
Balanca më 31 dhjetor 2022	-	(667)	(38,688)	(554,837)	(40,483)	(634,675)
Zhvlerësimi për vitin		(95)	(6,063)	(40,614)	(126,380)	(173,151)
Hegjet						
Balanca më 31 dhjetor 2023	-	(762)	(44,751)	(595,450)	(166,863)	(807,827)
Neto vlera						
Balanca më 31 dhjetor 2022	2,110,000	30,425	38,643	134,250	445,317	2,758,634
Balanca më 31 dhjetor 2023	3,381,000	180,330	90,206	342,504	525,102	4,519,142

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjerat janë të përbëra si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Të arkëtueshmet tregtare	165,632	307,420
Parapagimi ndaj punëtorëve		-
Parapagimi ndaj tatimit në fitim	23,741	20,515
Parapagimi ndaj tvsh-së		1,079
Gjithsej	189,373	329,014
Llogaritë e arkëtueshme nga qytetarët dhe bizneset	1,087,001	1,071,295
Inkasimet e borxheve të këqija	(41,636)	(38,133)
Minus provizionet	(234,477)	(234,477)
Të arkëtueshmet neto	810,889	798,685
Gjithsej	1,000,262	1,127,699

7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë janë të përbëra si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Paraja në arkë	141,516	1,161
Paraja në bankë	850	164,277
Gjithsej	142,367	165,438

8. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjerat janë të përbëra si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Furnitorët	52,978	45,809
Gjithsej	52,978	45,809

9. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore janë të përbëra si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Detyrimet ndaj punëtorëve	16,648	17,207
Detyrimet ndaj tatimit në fitim	-	3,742
Detyrimet ndaj TVSH	1,178	-
Gjithsej	17,826	20,949

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

10. Të hyrat e shtyera

Të hyrat e shtyera përbëhen nga si vijon:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Të hyrat nga donacioni	4,566	8,263
Të hyrat nga donacioni – GIZ & KK Gjakovë	525,102	445,317
Gjithsej	529,668	453,580

11. Të hyrat nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet përbëhen nga si vijon:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Të hyrat nga amvisëria	827,713	795,972
Të hyrat nga bizneset e vogla	191,741	182,915
Të hyrat nga institucionet	532,190	571,250
Të hyrat tjera	50,001	40,441
Nën-total (I)	1,601,646	1,590,578
Të hyrat tjera financiare	3,698	4,810
Të hyrat nga shitja e aseteve	7,684	17,908
Të hyrat tjera	2,579	3,231
Nën-total (II)	13,960	25,949
Të hyrat nga donacioni (III)	126,380	40,483
Gjithsej (I+II+III)	126,380	40,483

12. Shpenzimet e personelit

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e pagave neto	892,723	842,468
Shpenzimet e tatimit në paga	53,523	50,194
Shpenzimet e kontributeve	98,190	93,186
Gjithsej	1,044,437	985,847

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

13. Shpenzimet e materialit

Shpenzimet e materialit janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e materialit ndihmës	32,122	29,783
Shpenzimet e materialit për zyre	17,004	9,911
Shpenzimet e materialit për higjienë	976	758
Shpenzimet e energjisë elektrike	7,202	7,177
Shpenzimet e karburantit për auto	190,551	228,091
Shpenzimet e karburantit benzina	3,936	2,766
Shpenzimet e vajrave motorike	13,838	9,677
Shpenzimet e gazit- plinit	11	-
Gjithsej	265,641	288,164

14. Shpenzimet tjera

Shpenzimet tjera janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	480	786
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare (projekti)	-	1,360
Shpenzimet e revistave dhe publikimeve	6,980	3,690
Shpenzimet e përfaqësimit brenda	11,478	5,216
Shpenzimet e premisë së sigurimit	8,300	7,309
Shpenzimet tjera të premisë së sigurimit	5,687	4,896
Shpenzime të kuotave të anëtarësisë	10,000	4,590
Shpenzimet e tatimit mbi pasurinë	-	537
Shpenzimet gjyqësore	-	245
Shpenzimet e shërbimeve mjekësore	1,984	3,202
Shpenzimet e përmbaruesit	6,777	3,748
Gjithsej	51,687	35,578

15. Shpenzimet tjera afariste

Shpenzimet tjera afariste janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e ndërmjetme	4,961	4,687
Shpenzimet për shërbime komunale	3,618	3,281
Autogoma	29,007	23,679
Shpenzimet e shërbimeve të telefonit	4,505	4,073
Shpenzimet e shërbimeve tjera	20,139	17,004
Shërbimet tjera	105,138	72,918
Shërbimet e deponive së mbeturinave	171,823	132,871
Gjithsej	339,191	258,513

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

16. Shpenzimet e tatimit në fitim

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Fitimi para tatimit	(132,121)	18,909
<i>Rregulluar për:</i>		
Të hyrat e patatueshme		
Shpenzimet e pazbritshme	-	10,426
Fitimi para tatimit	-	29,334
Shpenzimet e tatimit (10 %)	-	2,933

17. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e kompanisë.

Transaksionet me palët e lidhura të përfshira gjatë periudhës së raportimit financiar ishin si më poshtë:

Përshkrimi i transaksionit	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Kompenzimi për menaxhmentin kyç	12,572	12,704
Bordi i drejtorëve	10,800	12,800

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

18. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

a. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se kompania do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vazhdueshmërisë, duke maksimizuar kthimin të aksionarët nëpërmjet optimizimit të borxhit dhe bilancit të kapitalit.

Struktura e kapitalit të kompanisë konsiston nga kapitali i zotëruesve të kapitalit që përmban kapitalin aksionar dhe fitimin e mbajtur, si dhe huatë.

Raporti i borxhit me kapitalin

Menaxhmenti i kompanisë rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi menaxhmenti ka parasysh koston e financimit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të financimit në kapital. Kompania nuk ka hyrë në zotime kontingjenca për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020.

Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Detajet e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe metodave të adoptuara, përfshirë kriteret për njohje, bazat për matje dhe bazat në të cilat njihen të hyrat dhe shpenzimet, sa i përket secilës klasë të pasurisë financiare, detyrimit financiar dhe instrumenti të kapitalit janë shpalosur në shënimin e politikave kontabël të këtyre pasqyrave financiare me sipër.

b. Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit kompania ka instrumentet financiare të mëposhtme:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
<u>Pasuritë financiare:</u>		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	1,000,262	1,127,699
Paraja në dorë dhe në banka	142,367	165,438
<u>Detyrimet financiare:</u>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	52,978	45,809
Detyrimet tatimore	17,826	20,949

c. Qëllimet e menaxhimit të rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve të ndryshme financiare, përfshirë rrezikun kreditor dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndërrimit të kurseve të këmbimit të valutave të huaja dhe normave të interesit. Menaxhmenti i rrezikut të kompanisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe mundohet të minimizojë efektet negative potenciale ndaj performancës së biznesit të kompanisë.

d. Rreziku i tregut

Rreziku i valutës së huaj

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të rëndësishme në kursin e këmbimit pasi që pjesa më e madhe e mjeteve të saj janë pranuar dhe shpenzuar në Euro. Kompania nuk përdorë asnjë instrument për mbrojtje ndaj rrezikut të këmbimit valuator.

Kompania nuk ka hyrë në asnjë ndërrim forward apo transaksion derivativ gjatë fund vitit 31 dhjetor 2022.

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

18. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)*Rreziku i normës së interesit*

Rreziku nga norma e interesit, kompania nuk ka rrezik nga normat e interesit deri sa nuk ka instrumente financiare në përdorim të cilat kanë të aplikuar norma interesi.

e. Rreziku kreditor

Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor përmes aktiviteteve të saj të operimit. Duke pasur këtë parasysh, rreziku kreditor i kompanisë rrjedh nga mundësia që anëtarët mund të dështojnë në përmbushjen e obligimeve të tyre kontraktuale.

Shuma e ekspozimit kreditor në këtë aspekt përfaqësohet nga vlera bartëse e pasurive në bilancin e gjendjes.

Shuma bartëse e pasurive financiare të regjistruara në pasqyrat financiare, të cilat janë neto duke ju zbritur humbjet nga dëmtimet, paraqesin ekspozimin maksimal të kompanisë ndaj rrezikut kreditor.

f. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktiviteteve të organizatës dhe menaxhimi i pozicioneve. Përfshinë edhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të financuar pasurinë me maturitet dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet.

Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore me qëllim që të menaxhojë obligimet e saj kur ato vijnë për tu përmbushur. Maturiteti kontraktual i instrumenteve financiare të kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 është si në vijim:

31 dhjetor 2023	Më pak se 1 muaj	1 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	142,367	-	-	142,367
Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera	1,000,262	-	-	1,000,262
Gjithsej pasuritë	1,142,629	-	-	1,142,629
Detyrimet				
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	52,978	-	-	52,978
Detyrimet tatimore	17,826			17,826
Gjithsej detyrimet	70,805	-	-	52,978
Pozita e likuiditetit	1,071,824	-	-	1,089,650
Hendeku i likuiditetit	1,071,824	1,071,824	1,071,824	

KRM ÇABRATI SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

18. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**f. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2022	Më pak se 1 muaj	1 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	165,438	-	-	165,438
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	1,127,699	-	-	1,127,699
Gjithsej pasuritë	1,293,137	-	-	1,293,137
Detyrimet				
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	45,809	-	-	45,809
Gjithsej detyrimet	45,809	-	-	45,809
Pozita e likuiditetit	1,247,327	-	-	1,247,327
Hendeku i likuiditetit	1,247,327	1,247,327	1,247,327	

g. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuar është e përafërt me vlerën e tyre të drejtë për shkak natyrës së tyre të shkurtër ose për shkak të faktit se termat e lidhura reflektojnë termat e tanishme të tregut.

19. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Më 31 dhjetor 2023 nuk janë identifikuar zotime apo detyrime kontingjente.

20. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin shpalosje në pasqyrat financiare të kompanisë.